

STABILIZIMI MAKROEKONOMIK  
PËRGJATË PERIUDHËS SË  
TRANZICIONIT

---

**Riccardo Faini**

**Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe CEPR**

## **1. PREZANTIM**

Stabilizimi makroekonomik është një parakusht për një rritje ekonomike të qëndrueshme (FMN, 2001). Eksperienca e vendeve në tranzicion dëshmon për këtë të vërtetë të thjeshtë (Wyplosz, 199). Në mungesë të stabilitetit të çmimeve dhe të politikave makroekonomike mbështetëse, investitorët do të jenë të rrezikuar të kryejnë investime afatgjata dhe kjo do të sjellë vështirësi në rritjen ekonomike.

Stabiliteti makroekonomik është i nevojshëm, por jo një kusht i mjaftueshëm për rritjen ekonomike. Institucione të forta, të drejta të pronësisë të përcaktuara saktë, një sistem gjyqësor efektiv janë, gjithashtu, të pashmangshme për një funksionim të mirë të sistemit të tregut.

Shqipëria ka bërë hapa të mëdhenj drejt stabilitetit të ekonomisë së saj. Fillimisht qëndronte frika se rënia e firmave piramidale do të krijonte kushtet për një periudhë të tejkgjatur dhe të thellë destabilizimi. Por, në të vërtetë kjo nuk ndodhi. Veprimet e politikave monetare dhe fiskale i lejuan autoritetet shqiptare që të rivendosnin stabilitetin makroekonomik. Inflacioni nga 32.1 për qind në vitin 1997, ra afërsisht zero.

Në mënyrë të dukshme, shqetësimi i konfliktit në Kosovë nuk e dëmtoi performancën makroekonomike. Në vitin 1999, inflacioni qëndroi çuditërisht i ulët, bile më i ulët se standardi i vendeve industriale, në 0.4 për qind. Në mënyrë të ngjashme, mbas rënies së vitit 1997, rritja ekonomike u përmirësua ndjeshëm në vitin 1998 dhe që nga ajo kohë është në një mesatare vjetore 7.7 për qind.

Këto arritje, gjithësesi nuk duhet të na vetkënaqin. Janë akoma dhe shumë pengesa të mëdha që ekonomia shqiptare duhet të përballojë. Forcimi i institucioneve të brendshme, rindërtimi i rregullave të ligjit në mënyrë të përshtatshme, vlerësimi i aftësive njëzëore dhe krijimi i kushteve për futjen e ndërmjetësimit financiar janë të pashmangshme për të siguruar një rritje ekonomike të qëndrueshme.

Në këtë material, pothuajse kam abstraguar nga programi i politikave strukturore, dhe jam përqendruar në fakt në problemet makroekonomike. Fillimisht vlerësoj arritjet makroekonomike, duke u përqendruar në rritjen ekonomike, në inflacionin dhe tek buxheti. Në këtë vlerësim, jam mbështetur në një grup vendesh të krahasueshme, që përfshin Bullgarinë, FYR e Maqedonisë dhe Rumaninë. Zgjedhja e këtyre vendeve është, në njëfarë mënyre, arbitrare por, shpreh dëshirën për të zgjedhur vende që janë të ngjashme me Shqipërinë përse i përket PBB-së për frymë.

Pjesa në vazhdim të këtij materiali është organizuar si më poshtë. Në pjesën e dytë, i kam kushtuar vëmendje arritjeve makroekonomike. Në pjesën e tretë janë përmendur disa sfida kyçe në fushën e politikave makroekonomike. Pjesa e fundit ofron disa konkluzione shkurt (të përmbledhura).

## **2. ARRITJET MAKROEKONOMIKE TË DERITANISHME**

### *a) Performanca e rritjes ekonomike.*

Në përgjithësi, Shqipëria ka patur një performancë relativisht të mirë krahasuar me vendet e tjera në tranzicion. Grafiku 1 tregon

këtë fakt. Pothuajse për të gjitha vendet në tranzicion, produkti në vitin 1999 ishte në të njëjtat nivele ose më poshtë se ai i vitit 1989, Polonia ishte përjashtimi i vetëm domethënës.

Për një pakicë vendesh- të gjitha të Europës Qendrore dhe që janë më shumë të predispozuar të hyjnë në Bashkimin European me valën e parë të pranimeve- PBB e vitit 1999 ishte relativisht shumë afër nivelit të saj para periudhës së tranzicionit. Sikurse është theksuar nga Fischer, Sahay and Vegh (1996), ka shumë arsye për të qenë të kujdesshëm në këtë krahasim (të dhënat e PBB-së të periudhës së paratranzicionit me të vërtetë, sikur duan të zmadhojnë rënien në prodhim). Grafiku 1, megjithatë është simbolikë e problemeve që shoqërojnë periudhën e tranzicionit.

Ka qënë një debat i zjarrtë për rastet e rënies së produktit gjatë periudhës së tranzicionit, ku në një nga alternativat, përgjegjësia për goditjet e para që mori sistemi i planifikimit të centralizuar, bie mbi ngjarjet *shock* ekzogjene, dhe politika e dështuar e “gjelit të ftohtë” (cold turkey). Shqipëria nuk mundi t'i shpëtojë një fati të tillë, me një nivel të produktit real, në vitin 1999, akoma më poshtë se një njësi. Por, megjithatë, duket qartë se performanca e Shqipërisë është më e mirë se e vendeve të tjera të krahasueshme me të.

Nëse do të përjashtonim vendet e Europës dhe do të përqendroheshim vetëm mbi Vendet Balltike dhe në vendet e tjera të Europës Jugore, vëmë re se rënia e produktit të Shqipërisë është dukshëm më pak e shprehur, përveç recesionit të ashpër, që Shqipërisë i duhej të kalonte mbas rënies së firmave piramidale në vitin 1997. Produkti real në Shqipëri për vitin 1999 është 0.93, kjo është e krahasueshme me mesataren e vendeve joballtike të pranuar në Bashkimin European (0.95) dhe duket qartë që është më mirë se ajo e Vendeve Balltike (0.77). Nëse do ta shtrinin krahasimin në vitet më të fundit, performanca e rritjes ekonomike të Shqipërisë është akoma më e dukshme. Ndërmjet viteve 1997 dhe 2000, rritja mesatare vjetore e PBB-së ishte 7.7 për qind, përkundrajt 3.8 për qind që ishte në Bullgari, -0.2 për qind që ishte në Rumani dhe 3.9 për qind që ishte në Maqedoni. Me rritjen e parashikuar për vitin 2001 rreth 7.3 për qind Shqipëria është që tani mbi nivelin e produktit të periudhës para tranzicionit.

#### *b) Të dhëna mbi inflacionin.*

Shumë vende në tranzicion kanë eksperiencë, edhe pse për kohë të shkurtër, të një inflacioni të lartë. Rritja e çmimeve shpjegon ngjarjet e para *shock* mbi çmimet, por nuk mund të shpjegojë

rritjen e vazhdueshme të inflacionit që vazhdoi më pas. Përhapja e mekanizmave në formën e indeksit të pagave dhe e politikave monetare akomoduese (përshtatëse) ishin instrumentet kryesore që lejuan një rritje të vazhdueshme në inflacion.

Sikurse është përmendur nga WYPLOSZ (1999) ka një lidhje (korrelacion) të konsiderueshme ndërmjet inflacionit dhe deficitit buxhetor, duke sugjeruar që mosbalancimi fiskal, financohet gjerësisht nga mjetet monetare. Mungesa e mënyrave të tjera të financimit shpjegon pse qeveritë i drejtohen financave inflacioniste dhe theksojnë lidhjen e ngushtë ndërmjet politikës fiskale dhe monetare.

Ku qëndron Shqipëria me zbatimin e mesatares të inflacionit, në krahasim me vendet në tranzicion? Përgjigja është: varet. Në qoftë se do të marrim në konsideratë periudhën mbas vitit 1997, të dhënat e Shqipërisë janë diçka më pak se “pa të meta”. Ndërmjet viteve 1989 dhe 1997 inflacioni mesatar arriti në 40 për qind, më pak se në pjesën më të madhe të vendeve të CIS, por më i lartë se në Vendet e Balltikut dhe në vendet e tjera të pranuar në Bashkimin Europian. Megjithatë, që nga viti 1998, inflacioni ka ardhur duke u ulur me shpejtësi. Falë zbatimit të një politike monetare të mirëpërcaktuar, inflacioni ka rënë në 0.4 për qind në vitin 1999 dhe realisht zero në vitin 2000<sup>30</sup>. Rritja më e fundit e inflacionit kryesisht reflekton ngjarjet *shock* të jashtme, si për shembull, rritja e çmimit të naftës, dhe duhet të përballohet me lehtësi, me kusht që të mos transmetohet nga politika të papërshtatshme. Duke iu referuar inflacionit, grafiku 2 tregon se si Shqipëria ka përparuar në baza krahasuese. Po të përjashtojmë vitet 1992 dhe 1997, ku pati një rritje galopante të inflacionit, çmimet u rritën me një ritëm pothuajse të moderuar në krahasim me vendet e tjera në tranzicion. Norma mesatare e inflacionit në Shqipëri është e krahasueshme me të dyja rastet, si me vendet jobaltike të pranuar në Bashkimin Europian (35.5 për qind) dhe me Vendet Baltike, dhe shumë më e mirë se vendet e tjera të Europës Juglindore.

c) *Buxheti.*

---

<sup>30</sup>Rreshtat në vazhdim janë shkruar plotësisht në mirëbesim. Unë shpresoj të mos e cënoj një mirëbesim të tillë në qoftë se përmend këtu, që pikëpamja e autoriteteve gjermane ishte se politika monetare në Shqipëri është në njëfarë mënyre shtrënguese.

Sikurse dhe u përmend, mosbalancimi i buxhetit mund të luajë një rol thelbësor në nxitjen e inflacionit. Shqipëria nuk është rasti i veçantë i këtij rregulli. Në vitin 1992, deficitin buxhetor përbënte një shifër marramendëse, 20.2 për qind e PBB-së. Më pas, pati një rënie të vazhdueshme, me përjashtim të rritjes në vitin 1997, por sidoqoftë deri në vitin 1999 ai vazhdonte të ishte akoma në vlerë dyshifrore.

Vetëm në vitin 2000, deficitin buxhetor mundi të binte nën vlerën 10 për qind. Ajo çfarë ka më shumë rëndësi në përcaktimin e inflacionit është pjesa e financimit të brendshëm në deficitin buxhetor. Këtu, gjithashtu, Shqipëria ka shënuar një përmirësim të vazhdueshëm. Pjesa e financimit të brendshëm në deficitin buxhetor ra nga 11 për qind në vitin 1997, në 4.9 për qind në vitin 2000.

### **3. SFIDAT QË NA PRESIN**

#### *a) Konsolidimi fiskal i mëtejshëm.*

Politika fiskale është e detyruar të luajë një rol kyç në krijimin e formës të perspektivës afatmesme ekonomike të Shqipërisë. Kjo nuk është vetëm sepse ndershmëria fiskale është një përbërës thelbësor i stabilitetit makroekonomik. Po të përjashtojmë progresin e dukshëm të kohëve të fundit, më themelore është, se aftësia e Shqipërisë për të rritur të ardhurat është akoma, pothuajse e kufizuar, e vlerësuar kjo me vende të tjera të krahasueshme me të.

për qind në Rumani, por vetëm 23 për qind në Shqipëri. Diferenca është akoma më e madhe në qoftë se marrim në konsideratë përbërjen e totalit të të ardhurave. Taksat doganore luajnë një rol shumë më të madh se në vendet krahasuese me të, duke u llogaritur 2.5 për qind e PBB-së dhe 11.4 për qind e të ardhurave totale. Për Bullgarinë dhe Rumaninë taksat doganore paraqesin respektivisht vetëm 0.9 dhe 1.1 të PBB-së. Pjesa e tyre në të ardhurat totale është e barabartë me 2.2 dhe 3.5 për qind respektivisht. Vetëm shifrat e Maqedonisë, ku pesha e të ardhurave nga tarifatat doganore, zë respektivisht 4 dhe 11.2 për qind, janë të krahasueshme me Shqipërinë. Kontributi i madh i taksave doganore në të ardhurat totale është pengesa më e madhe për zhvillimin e një sistemi taksash të shëndetshëm. Përderisa është e vërtetë që tregtia dhe importet, janë në rritje si përqindje ndaj totalit të produktit, forca e pakundërshtueshme e

liberalizimit të tregtisë, dikton një rënie të rëndësishme të taksave doganore. Së pari, pranimi i Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) kërkon një ulje të tarifave mesatare efektive. Është e rëndësishme të theksohet se, procesi integrimit ekonomik drejt Bashkimit Europian, kërkesa jetësore e Shqipërisë që të jetë në gjendje të shfrytëzojë përfitimet e tregtisë ndërkombëtare, do të kërkojnë një reduktim të rëndësishëm të barrierave për tregtinë, së paku në një periudhë afatmesme. Nevoja për gjetjen e burimeve të reja për të ardhurat është sfida kyçe për hartuesit e politikave në Shqipëri, në të dyja këndvështrimet, në uljen e burimeve ekzistuese dhe në kërkesën e ngutshme në burimet publike për infrastrukturën sociale dhe produktive.

**Tabelë 1 . Niveli i të ardhurave.**

	Të ardhura/PBB	Taksa doganore/PBB	Taksa doganore/Të ardhurat
Shqipëria	23.0	2.5	11.4
Bullgari	40.0	0.9	2.2
FYR Maqedoni	35.3	4.0	11.2
Rumani	31.5	1.1	3.5

*b) Harmonizimi ndërmjet konvergjencave të çmimeve dhe stabilitetit të çmimeve.*

Pjesa më e madhe e vendeve në tranzicion përballohen me vendimmarrje të vështira. Nga njëra anë dëshira për të tërhequr kërkesat e investitorit për një kuadër makroekonomik stabil dhe inflacion të ulët (çmime të ulta). Investitorët e huaj janë të frenuar nga inflacioni i lartë dhe kryesisht, dhe ndoshta i paqëndrueshëm, nga mbiçmimi i kursit real të këmbimit. Në anën tjetër, procesi i konvergjencës ekonomike drejt normave europiane kërkon një rritje në nivelin e çmimeve, në veçanti për mallrat e patregtueshëm- i ashtuquajtur efekti i Balassa-Samuelson – dhe një vlerësim të kursit real të këmbimit. Ky është një fenomen ekuilibri, por mund të jetë e vështirë të dallohet nga një shkallë e lartë paqëndrueshmërie e vlerësimit real.

Mund të duket sikur një zgjedhje e përshtatshme e regjimit të kursit të këmbimit mund të jetë në njëfarë mënyre e drejtuar nga kjo vendimmarrje. Por, kjo nuk është e vërtetë. Së pari, vendet në tranzicion të suksesshëm kanë përshtatur lloje të ndryshme regjimesh të kursit të këmbimit, që nga luhatja e lirë e kurseve dhe deri tek regjimi i drejtuar i tyre. Së dyti, dilema ndërmjet stabilitetit të çmimeve dhe ekuilibrit të mbiçmimit real është e pranishme,

megjithëse në forma të ndryshme, në të gjitha llojet e regjimeve të kurseve të këmbimit.

Shqipëria ka zgjedhur sistemin e kurseve luhatëse, që kërkon një administrim të kujdesshëm nga banka qendrore. Një administrim i kujdesshëm dhe i mirëformular i politikës monetare ka shërbyer si instrument në reduktimin e presioneve inflacioniste, edhe në përballimin e ngjarjeve madhore *shock* siç ishte lufta në Kosovë. Në të njëjtën kohë, nuk mundi të evitojë një mbiçmim të rëndësishëm të kursit real të këmbimit (grafiku 4). Duke e krahasuar me vendet e tjera të Europës Jugore, ku mbiçmimi real ka qenë në mënyrë të dukshme më i moderuar, pyetja shtrohet, nëse lëvizjet në kursin nominal të këmbimit kanë qenë tepër nxitëse, në përshpejtimin e tendencës në rritje të kursit real të këmbimit.

Një karakteristikë dalluese e Shqipërisë, është hyrja e madhe e dërgesave të huaja. Llogaria e transfertave private përbën 14.1 për qind të PBB-së kundrejt 2.5 për qind, që përbën në Bullgari, 2.3 për qind në Rumani dhe 10 për qind në FYR të Maqedonisë. Kjo, nga ana e saj, mund të ndikojë pjesërisht për një tendencë në mbiçmim të kursit real të këmbimit. Tashmë, fakti qëndron që në tre vendet krahasuese, kursi nuk është mbiçmuar dukshëm në këto tre vite të fundit dhe as që nuk ka rënë si në rastin e Rumanisë dhe të FYR të Maqedonisë.

*c) Nevoja për të këmbëngulur me reformat strukturore.*


Megjithë përpjekjet e saj, Shqipëria vazhdon akoma të qëndrojë mbrapa vendeve të tjera në tranzicion, në kuadrin e reformave strukturore. Indeksi i tranzicionit mesatar të BERZH –it e rradhit Shqipërinë mbrapa vendeve jobaltike të pranuar në Bashkimin Europian, mbrapa të gjitha Vendeve Balltike dhe të gjitha vendeve të Europës Juglindore, me të vetmin përjashtim të Bosnje-Herzegovinës (grafiku 3). Vetëm për privatizimin në nivele të ulta dhe për reformat në tregti dhe në sistemin e kursit të këmbimit, Shqipëria është e barabartë me vendet e tjera në tranzicion. Të dhënat e Shqipërisë janë në veçanti të dobëta në fushën e privatizimit të niveleve të larta, në ristrukturimin e ndërmarrjeve, në politikat konkurruese dhe në reformat e tregut financiar. Privatizimi i planifikuar i Bankës së Kursimeve duhet të bëhet duke patur parasysh problemin e fundit të ngritur. Liberalizimi i tregut financiar

gjithësesi, do ta privojë Thesarin, nga burime financiare të vazhdueshme dhe relativisht të lira. Për këtë arsye, është e nevojshme, të kryhen përpjekje përcaktuese për të zbuluar burime të tjera të të ardhurave, duke nënvizuar edhe një herë nevojën për të zbatuar një reformë të gjerë taksash duke patur parasysh forcimin e një sistemi taksash frytdhënës.


#### 4. KONKLuzionET

Stabiliteti makroekonomik, një arritje e vështirë tashmë, i ka dhënë frutet e tij në kushtet e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe të lartë. Kjo i ka forcuar konvergjenat e Shqipërisë drejt Europës. Për të mbështetur një proces të tillë, janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme në drejtim të reformave strukturore, në veçanti në fushën e reformave të sektorit financiar dhe të liberalizimit të mëtejshëm të tregtisë. Të dyja këto reforma, gjithësesi, kanë nevojë për heqjen dorë nga një pjesë e të ardhurave për Thesarin, dhe në të njëjtën kohë kur detyrimet sociale dhe të zhvillimit të qeverisë janë kufizuar, të ngrihen. Një reformë e thellë taksash, si dhe një mbikëqyrje në rritje dhe rigorozë e programit ekzistues të shpenzimeve, do të kërkojë, për këtë arsye, të parandalojë rezistencën e kësaj vendimmarrjeje të vështirë, ndërmjet nevojës së ngutshme për stabilitet makroekonomik dhe domosdoshmërisë për të shkuar përpara me reformime të mëtejshme.

Grafik. 1  
PPP PBB për frymë 1999.



Grafik 2  
Mesatarja e indeksit të BERZH-it për  
Infliçionin në tranzicion.



**Grafik 4**  
**Kursi real i këmbimit.**

